




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i biznesit: OJQ-Ardhmëria e Qytetit të Ferizajt
Numri Unik Identifikues: 5101571-1
Drejtor: Driton Ramadani
OSHMA: Radio FERIZAJ
Adresa: Rr/ Dëshmoret e Kombit Ferizaj



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio Ferizaj, me seli në Ferizaj

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.
2. Radio Ferizaj është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Ferizaj. KPM, me vendimin e datës 28 gusht 2016, lëshimin e licencës së Radio Ferizaj për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 28 gusht 2023, skadon afati i licencës së Radio Ferizaj.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afati i licencës ju skadon në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Ferizaj, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 17 korrik 2023, Radio Ferizaj ka dorëzuar kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës.

Arsyetim

5. Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të

frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

6. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizuel privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.*
7. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Ferizaj lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
8. Komisioni konstaton se, Radio Ferizaj përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar.
9. Komisioni e KPM-së konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, të Radio Ferizaj të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje e licencës.
10. Komisioni konstaton se Radio Ferizaj ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
11. Komisioni konstaton se në bazë të certifikatës së regjistrimit të OJQ-së në emër të së cilës është ndryshuar licenca konstatohet se nuk ka ndryshime në pronësi të Radio Ferizaj.
12. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Ferizaj është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Ferizaj i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën operon kjo radio.

Vendim

13. Komisioni në takimin e datës 1 shtator 2023, merr vendim për miratimin e kërkesës për ripërtëritjen e licencës për Radio Ferizaj për vazhdimin e veprimtarisë të ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Ferizaj.
14. Licenca e Radio Ferizaj do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2023.

15. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Ferizaj, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.

16. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



01.09.2023

datë